

- Doc&docId=DC677_En&caseId=C140
9. <http://icsid.worldbank.org/ICSID/FrontServlet?requestType=CasesRH&actionVal=showDoc&docId=DC533&caseId=C148>
 10. <http://icsid.worldbank.org/ICSID/FrontServlet?requestType=CasesRH&actionVal=showDoc&docId=DC536&caseId=C15>
 11. <http://www.worldbank.org/afr/wps/wp62.pdf>
 12. http://icsid.worldbank.org/ICSID/FrontServlet?requestType=CasesRH&actionVal=showDoc&docId=DC569_En&caseId=C165
 13. www.iusct.org/general-declaration.pdf

Roli i Gjykatës Evropiane të Drejtësisë ne interpretimin e rregullave të lëvizjes së lirë të personave

Sokol Bana PhD

Abstrakt

Lëvizja e lirë është një e drejtë themelore në Bashkimin Europian. E drejta e Bashkimit Europian dhe në këtë kuadër edhe lëvizja e lirë e shtetasve evropianë udhëhiqet nga disa parime shumë të rëndësishme që përbëjnë bazën e zhvillimit dhe funksionimit të Tregut të Përbashkët Evropian. Lëvizja e lirë si një nga katër liritë themelore që siguron tregu i përbashkët udhëhiqet nga parimi i respektimit dhe mbrojtjes të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Ashtu siç do të trajtohet në këtë artikull, lëvizja e lirë është një ndër të drejtat e patjetërsueshme të njeriut, e cila në legjislacionin e BE-së ka marrë një dimension shumë më të gjerë e të avancuar. Gjykata e Drejtësisë ka luajtur një rol shumë të rëndësishëm për afirmimin progresiv të lëvizjes së lirë të personave. Nëpërmjet një interpretimi gjithnjë në rritje të legjislacionit komunitar, Gjykata i ka dhënë një zgjerim fushës së aplikimit të dispozitave të Traktatit për lëvizjen e lirë të personave, duke hequr pothuajse plotësisht kufirin e parë që ia njihje këtë të drejtë vetëm një kategorie të ngushtë operatorësh ekonomikë.

***Fjalet Kyçe:** lëvizja e lirë, Bashkimin Europian, shtetas komunitarë, shtetas jo komunitarë, jurisprudenca e GEJD-së etj.*

1. Hyrje

Lëvizja e lirë është një e drejtë parashikon që çdo individ i një shteti, në cilin ky është rezident, mund të largohet nga shteti i tij, me dokumentacionin përkatës të udhëtojë sa herë që ai dëshiron dhe të mund të kthehet tek shteti i origjinës në çdo

kohë. Ajo lidhet me te drejtat qe garantohen në kuadër të tregut të përbashkët. Këto të drejta parashikohen dhe garantohen në legjislacionet e shumë shteteve. Kjo e drejtë parashikon që çdo individ i një shteti, në cilin ky është rezident, mund të largohet nga shteti i tij, me dokumentacionin përkatës të udhëtoje sa herë që ai dëshiron dhe të mund të kthehet tek shteti i origjinës në çdo kohë; kjo e drejte parashikon gjithashtu, të drejtën e individit të udhëtoje, të banojë dhe/ose të punojë në çdo pjesë të vendit ku qytetari dëshiron, pa ndërhyrje nga shteti.

E drejta e lëvizjes së lirë ndryshon në lidhje me kontekstin në të cilin ajo analizohet. Ajo analizohet në kontekstin ndërkombëtar, në atë europian ose në kontekstin e legjislacionit të brendshëm. N.q.s. do i referohemi këtij të fundit (legjislacionit shqiptar) neni 38 i Kushtetutës së Shqipërisë thotë shprehimisht: “Kushdo ka të drejtë të zgjedhë vendbanimin si dhe të lëvizë lirisht në çdo pjesë të territorit të shtetit. Askush nuk mund të pengohet të dalë lirisht jashtë shtetit.” Në këtë drejtim lëvizja e lirë i referohet lirisë për të lëvizur lirisht në çdo pjesë të vendit, territorit të shtetit shqiptar si dhe në gëzimin e kësaj të drejte shteti nuk mund të ndërhyjë. Paragrafi i dytë i nenit në fjalë sanksionon lirinë për të dalë nga shteti. Po kështu, edhe në përputhje me Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut (1948) të gjithë personat gëzojnë një sërë të drejtash të patjetërsueshme të cilat janë “bazat e lirisë dhe të drejtësisë në botë”. Neni 13 i Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut sanksionon shprehimisht: “Çdo person ka të drejtë të qarkullojë lirisht dhe të zgjedhë vendbanimin e tij brenda një shteti. Çdo person ka të drejtë të largohet nga çdo vend, përfshirë edhe vendin e vet, si dhe të kthehet në vendin e tij.”. Ndonëse mund të duket se kjo e drejtë aplikohet më shumë për emigrantët, ajo ka shtrirje të gjerë edhe tek persona të tjerë po në kuadër të emigracionit si per shembull per azil-kërkuesit, refugjatët, studentet apo për familjarët në përgjithësi. Kjo e drejtë e patjetërsueshme e lirisë shtrihet, ne thelb, tek të gjithë personat.

Një kuptim shumë më të gjerë dhe me karakteristika më të veçanta merr liria e lëvizjes në legjislacionin europian (*acquis communautaire*). Në Bashkimin Europian garantohen katër liri/të drejta themelore: liria e qarkullimit të mallrave, personave, shërbimeve dhe kapitaleve. Tregu i përbashkët në BE përfshin pikerisht lëvizjen e lirë të mallrave, të personave, të shërbimeve dhe të kapitaleve. Realizimi i këtij tregu, ashtu siç parashikohet në nenin 2 TBE, parashikon eliminimin mes Shteteve anëtare të pengesave për shkëmbimet e mallrave, për qarkullimin e lirë të personave, shërbimeve dhe kapitaleve. Tregu i brendshëm, i sanksionuar në nenin 14 TBE përfshin “një hapësirë pa kufij të brendshëm ku lëvizja e lirë e mallrave, e personave, e shërbimeve dhe e kapitaleve është e garantuar në përputhje me dispozitat e këtij Traktati”. Dy parime të tjera mjaft të rëndësishme, që qëndrojnë ngushtësisht të lidhura me njëra-tjetrën në BE, janë ndalimi i diskriminimit dhe trajtimi i barabartë, të cilët sanksionohen në nenin 12, të TBE-së. Parimi i parë

nënkupton që asnjë shtetas i cili lëviz nga shteti i origjinës në një shtet tjetër të Bashkimit nuk mund të diskriminohet për shkak të kombësisë, gjinisë, përkatësisë fetare, etnike, shoqërore etj.

Lëvizja e lirë e këtyre personave në BE nuk mund të kuptohet vetëm në kuptimin e ngushtë të fjalës, si lëvizje e thjeshtë, tranzitore, por edhe si e drejta e këtyre personave për t’u vendosur në një nga shtetet anëtare, për të studiuar, për të punuar, për të marrë me vete familjarët dhe për të pasur një trajtim të barabartë me shtetasit e atij shteti. Kjo e drejtë themelore e shtetasve evropianë fillimisht ka pasur një konotacion ekskluzivisht ekonomik dhe gjente aplikim vetëm për lëvizjen e lirë të punëtorëve të punësuar apo të vetëpunësuar, në të drejtën e qëndrimit dhe ofrimit të shërbimeve. Personat, të cilët konsideroheshin si forcë punëtore, përbënin faktorin e tretë të prodhimit të mallrave dhe kapitaleve në atë kohë dhe për këtë arsye lëvizja e tyre është parë gjithmonë si një hallkë e nevojshme për qarkullimin e lirë të dy faktorëve të tjerë. Liria e qarkullimit të personave, në veçanti, është objekt i një parimi themelor i destinuar për të kënaqur nevojat të gjithë shtetasve komunitarë duke u mundësuar dhe lehtësuar atyre ushtrimin e një aktiviteti përtej kufijve shtetërorë. Për sa i përket konceptit të lëvizjes së lirë, ai shtrihet edhe tek shtetasit jo komunitarë. Hyrja dhe qëndrimi i shtetasve jo komunitarë ka qenë prerogativë e sovranitetit të Shteteve anëtare të cilat i vendosnin vetë kushtet dhe kriteret për ushtrimin e kësaj të drejte.

2. Baza ligjore

Pavarësisht se dispozitat origjinale të Traktateve i referohen vetëm ndryshimeve të rëndësishme ekonomike, e drejta komunitare ka zgjeruar në mënyrë progresive konceptin e lirisë së qarkullimit, duke e shtrirë këtë liri tek të gjithë personat që kanë shtetësinë e një Shteti anëtar të BE-së dhe që transferohen nga një vend anëtar në tjetrin¹. Gjykata Europiane e Drejtësisë, në fakt, e ka zgjeruar shumë sferën e subjekteve që mund të përfitojnë nga kjo liri, duke kaluar përtej rasteve tipike të lidhura me punën, me qëndrimin dhe dhënien e shërbimeve. Është arritur në një rezultat të tillë qoftë duke interpretuar në mënyrë të gjerë kategorinë e personave të përcaktuara në traktat, qoftë duke zgjeruar kategorite e aktiviteteve të punës, po ashtu duke futur kategori të reja personash që mund të përfitojnë këtë liri edhe duke mos qenë të përcaktuar në mënyrë të qartë në traktat. Një zgjerim/shtrirje të tillë e gjejmë në legjislacionin komunitar edhe për familjarët e punëtorëve, për kategorinë e shtetasve që nuk janë punëtorë, punëtorëve që nuk mund të punojnë me për arsye moshe, invaliditeti etj. dhe per studentët me kushtin që të disponojnë të ardhurat e duhura për të jetuar. Një rol të veçantë në këtë

¹ Shih direktivën 2004/38/KE të 28 prillit të vitit 2004.

drejtim ka luajtur edhe normativa dytësore (rregulloret dhe direktivat), duke bërë që t'u njihet e drejta e lëvizjes së lirë pothuajse të gjithë shtetasve të Bashkimit European, duke përfshirë këtu edhe ata individë të cilët qarkullojnë edhe pa u punësuar. Me tre direktivat e vitit 1990, që kanë të bëjnë me shtrirjen e të drejtës së lëvizjes së lirë dhe qëndrimit, iu njoh e drejta e qëndrimit të gjithë punonjësve të cilët i kanë përfunduar marrëdhëniet e punës, studentëve dhe të gjithë personave të cilët disponojnë të ardhura ekonomike të mjaftueshme për të jetuar².

E drejta për të qarkulluar dhe qëndruar lirisht mbi të gjithë territorin komunitar është përforcuar në vazhdim me dispozitat e reja lidhur me shtetësinë europiane të futura në traktatin e Maastricht-it. Paragrafi 1 i nenit 21 (ish neni 18) TBE tregon, në fakt, se çdo shtetas i Bashkimit European ka të drejtën e qarkullimit dhe të qëndrimit lirisht në territoret e vendeve anëtare, duke e shtrirë këtë të drejtë për të gjithë shtetasit e Bashkimit European, nisur nga fakti se mund të kryejnë një aktivitet në një vend tjetër anëtar. Sipas nenit në fjalë "Çdo shtetas i Bashkimit gëzon të drejtën e lëvizjes dhe të qëndrimit në mënyrë të lirë brenda territoreve të Shteteve anëtare, e drejtë kjo që është subjekt i kufizimeve dhe i kushteve të përcaktuara në këtë Traktat dhe i masave që merren për ta vënë këtë në zbatim". Kjo dispozitë përbën tani bazën juridike mbi të cilën bazohet e gjithë disiplina komunitare në fushën e qarkullimit dhe të qëndrimit të lirë të qytetarëve komunitarë.

Një rëndësi të veçantë në këtë fushë ka Direktiva 2004/38/KE e cila ka riorganizuar dhe modifikuar aktet ligjore të mëparshme të BE-së që disiplinonin në mënyrë jo unike qarkullimin e lirë të punëtorëve vartës, punëtorëve autonome, studentëve, personave jo aktivë ekonomikisht³. Ajo rregullon në një tekst të vetëm legjislativ të drejtën për të qarkulluar lirshëm të shtetasve komunitarë dhe familjarëve të tyre në Bashkimin European.

Neni 21 TBE, së bashku me jurisprudencën e GJED-së dhe direktiva 2004/38/KE, kanë shënuar në mënyrë definitive kapërcimin e konceptit merkantilist të së drejtës së lëvizjes së lirë: pra, jo më lëvizje e lirë në funksion të ushtrimit të një aktiviteti ekonomik por qarkullim i lirë dhe qëndrim si shtetas të Bashkimit European. Në lidhje me këtë shtohet edhe një koncept ose fenomen i ri përveç tregut të përbashkët që është "hapësira e lirisë, sigurisë dhe drejtësisë", nëpërmjet të cilës realizohet edhe qarkullimi i lirë i personave. Pra, qarkullimi i lirë i personave në Bashkimin European nënkupton lëvizjen e lirë të shtetasve të vendeve anëtare të

² Bëhet fjalë për direktivat e Këshillit, n. 90/364/KEE, 90/365/KEE, 90/366/KEE të 28 qershor të vitit 1990, të publikuara në Fletoren Zyrtare të BE-së, L 180, e datës 13 korrik të vitit 1990. Direktiva 90/366 që parashikonte të drejtën e qarkullimit të lirë të studentëve u anulua nga Gjykata e Drejtësisë (çështja *Parlamenti k. Këshillit*, C-295/90 e datës 7 korrik të vitit 1992, por ajo "rigjenerohet" në direktivën 93/96/KEE (botuar në Fletoren Zyrtare të BE-së, L 137, e datës 18 dhjetor të vitit 1993).

³ Ky term i referohet të gjithë personave-shtetas komunitarë që janë transferuar në një shtet tjetër anëtar të BE-së për arsye të vetme për të jetuar aty (pra, jo për t'u punësuar) pasi ata disponojnë të ardhura të mjaftueshme për të bërë një jetë normale në atë shtet ku janë transferuar.

"hapësirës së lirisë, sigurisë dhe drejtësisë", brenda hapësirës së këtyre shteteve pa asnjë pengesë administrative.

Lëvizja e lirë e këtyre personave në BE nuk mund të kuptohet vetëm në kuptimin e ngushtë të fjalës, si lëvizje e thjeshtë, tranzitore, por edhe si e drejta e këtyre personave për tu vendosur në një nga shtetet anëtare, për të studiuar, për të punuar, për të marrë me vete familjarët dhe për të pasur një trajtim të barabartë me shtetasit e atij shteti⁴.

Sot, përfitojnë nga regjimi i lëvizjes së lirë të gjithë personat që janë shtetas të një shteti anëtar të Bashkimit European. Nga kjo e drejtë përfitojnë edhe personat të cilat kanë dy shtetësi, një të një Shteti anëtar të BE-së dhe shtetësinë e një shteti jo anëtar.

Ajo realizohet nëpërmjet hapësirës së lirisë, sigurisë dhe drejtësisë, një hapësirë kjo, e fundit pa kufij të brendshëm. Eliminimi i kufijve të brendshëm kërkon rritjen e menaxhimit të kufijve të jashtëm dhe një hyrje e rregulluar; si dhe të qëndrimit të qytetarëve të huaj, duke përfshirë edhe përmes një politike të përbashkët mbi azilin dhe emigracionin. Për sa i përket konceptit të lëvizjes së lirë, ai shtrihet edhe tek shtetasit jo komunitarë. Hyrja dhe qëndrimi i shtetasve jo komunitarë ka qenë prerogative e sovranitetit të Shteteve anëtare të cilat i vendosnin vetë kushtet dhe kriteret për ushtrimin e kësaj të drejte. Koncepti i lëvizjes së lirë të personave, lindur me nënshkrimin e Marrëveshjes së Shengenit në vitin 1985 dhe pasuesen e Shengen në 1990, Konventa, e cila hoqi kontrollin e kufijve midis vendeve pjesëmarrëse. Bashkëpunimi Shengen, si pjesë e kuadrit ligjor dhe institucional të BE-së, është zgjeruar gradualisht në shumicën e shteteve anëtare të BE-së dhe disa vende jashtë BE-së.

Sot, regjimi i lëvizjes së lirë të shtetasve jo komunitarë në Bashkimin European është një ndërthurje e rregullave të vendosura në kuadër të Marrëveshjeve Shengen dhe rregullave të vendosura nga secili Shtet Anëtar, në varësi të arsyeve dhe kohës së qëndrimit.

3. Jurisprudenca e Gjykatës europiane të Drejtësisë

Gjykata e Drejtësisë ka luajtur një rol shumë të rëndësishëm për afirmimin progresiv të lëvizjes së lirë të personave. Nëpërmjet një interpretimi gjithnjë në rritje të legjislacionit komunitar, Gjykata i ka dhënë një zgjerim fushës së aplikimit të dispozitave të Traktatit për lëvizjen e lirë të personave, duke hequr pothuajse plotësisht kufirin e parë që ia njihnte këtë të drejtë vetëm një kategorie të ngushtë

⁴ Cassese S., "La cittadinanza europea e le prospettive di sviluppo dell'Europa", në Rivista italiana di diritto pubblico comunitario, 1996, fq. 869; Daniele L., "Diritto del mercato unico europeo", Milano, 2006.

operatorësh ekonomikë⁵, me anën e një procesi të quajtur “përngadalësim të funksionimit ekonomik të lëvizjes së lirë”.

Ky rezultat është arritur falë interpretimit zgjerues të kategorive të personave që përfitojnë nga lëvizja e lirë të përcaktuar në Traktat, të konceptit të aktivitetit ekonomik, (GJED, Vendimi 3 korrik 1986 *Lawrie- Blum* çështja 66/55), si dhe duke shtuar kategori të tjera të personave jo të përfshirë.

Në këtë mënyrë janë futur në kategorinë e përfituesve të lëvizjes së lirë, jo vetëm ofruesit por dhe përfituesit e shërbimit, duke përfshirë dhe turistët, duke krijuar në këtë mënyrë të drejtën për të hyrë në territoret e Shteteve anëtare për të gjithë shtetasit komunitarë.

Vlen të përmendet këtu vendimi i çështjes *Luisi e Carbone* (Vendimi 31 janar 1984, çështjet e bashkuara 286/82 dhe 26/83, *Luisi e Carbone*, pika 16, GJED) në të cilën Gjykata theksoi se në bazë të nenit 49 të Traktatit (aktualisht neni 40), për të bërë të mundur lëvizjen e shërbimeve është e lejuar jo vetëm zhvendosja e ofruesit të shërbimeve në Shtetin anëtar ku është përfituesi i shërbimeve, por dhe zhvendosjen e këtij të fundit në Shtetin ku ofruesi i shërbimeve ka vendqëndrimin, kështu është saktësuar e drejta e përfituesit të shërbimeve për të lëvizur lirisht në një Shtet anëtar me qëllim përfitimin nga një shërbim (GJED, Vendimi 7 korrik 1976, çështja 118/75 *Watson dhe Belman*). Kjo e drejtë nuk duhet të jetë e ndaluar nga asnjë kushtëzim. Kështu zgjerohet lëvizja e lirë e kapitaleve, “*ratione personae*” dhe e turistëve, pacientëve që përdorin shërbimet mjekësore, studentëve për udhëtimet e studimit, meqë konsiderohen si përfitues të shërbimeve.

Në çështjen *Cowan* (Vendimi 2 shkurt 1989, *Cowan*, çështja 186/87, pika 15, GJED), Gjykata Evropiane e Drejtësisë merr një nga vendimet më të përparuar në fushën e lëvizjes së lirë të personave. Në këtë çështje diskutohet nëse i duhet njohur apo jo e drejta e dëmshpërblimit për vuajtje dhune një turisti anglez i cili kishte pësuar një akt dhune në Francë. Shteti francez i njej të drejtën e këtij dëmshpërblimi çdo shtetasi të vet që pëson dhunime. Shteti francez nuk pranonte aplikimin e ligjit të brendshëm në këtë rast pasi theksonte që kjo fushë nuk hyn në fushën e aplikimit të Traktatit. Gjykata vendosi se dhe pse në parim kjo kompetence i përkiste shtetit anëtar, gjithsesi legjislacioni komunitar i vendoste disa limite kësaj kompetence.

Ndërsa Rasti *Gzerlczyk* ka të bëjë me çështjen e përfitimit të sigurimeve shoqërore nga shtetasit e BE-së që ndjekin studimet në një Shtet tjetër Anëtar dhe GJED-ja në paragrafin 39 të atij vendimi (më lart) tërhoqi vëmendjen ndaj faktit që Direktiva e Qëndrimit për studentët nuk vendoste ndonjë të drejtë për të paguar një bursë shteti. Gjithsesi, në çështjen *Bidar*, GJED-ja u konfrontua pikërisht me këtë situatën e fundit—d.m.th një student me shtetësi franceze që

⁵ Vendimi i 13 korrik 1986, *Lawrie – Blum*, çështja 66/85, Racc. p. 1 – 2121, ne të cilin Gjykata nxjerr përkufizimin e punëtorit për të cilin zbatohet legjislacioni kombëtar, duke e ngushtuar konceptin me lidhjen e saj të zbatimit të ligjit.

aplikoi në Britaninë e Madhe për një kredi studimi ose bursë për të financuar koston e studimeve të tij atje.⁶ Çështja ishte nëse kjo asistencë jetese, pavarësisht kushteve kufizuese në Direktivën e Qëndrimit dhe në praktikën e mëparshme gjyqësore në rastin *Brown* dhe *Lair*, përfshihej në fushën e Traktatit në lidhje me diskriminimin sipas nenit 12 KE. Gjykata, duke ndjekur një linjë mjaft të ngjashme arsyetimi me atë të rastit *Grezlczyk*, u mbështet në futjen e shtetësisë së BE-së dhe në ndryshimet e kompetencave arsimore dhe të trajnimit profesional sipas së drejtës së Traktatit të KE-së, për t’u larguar nga konkluzionet e saj të mëparshme në rastet *Brown* dhe *Lair* dhe për të vendosur se bursat shtetërore për studentët tani përfshiheshin vërtet në fushën e nenit 12.⁷

Gjykata duke lidhur lëvizjen e lirë të marrësve të shërbimeve me parimin e mos diskriminimit me bazë kombësinë, u përgjigj pozitivisht, duke theksuar “që mbrojtja e integritetit fizik të një personi, e liria e lëvizjes është e garantuar nga legjislacioni komunitar, ai vendos në lidhje me këtë liri”. Nga leximi i këtyre vendimeve del qartë se çdo shtetas që shkon në një Shtet anëtar për motive jo pune është përfitues, në territorin e këtij Shteti, të një sërë shërbimesh (shpenzime akomodimi, të transportit, të ngrënies).

Gjithmonë e lidhur me fushën e aplikimit të *ratione personae*, në normat mbi lëvizjen e lirë të punëtorëve, në nenin 45 (ish neni 39 TBE-së), futet dhe lëvizja e studenteve për një formim profesional⁸, gjithashtu dhe lëvizja për kërkimin e një vendi pune në një Shtet tjetër. Me shumë rëndësi është edhe vendimi i çështjes *Antonissen* (Vendimi 26 shkurt 1961, *Antonissen*, çështja C-292/89, GJED), në të cilën Gjykata bën një interpretim të ngushtë të nenit 45 paragrafi 3 (ish neni 48), i cili përfshin mundësinë efektive të një shtetasi të një Shteti anëtar që është në kërkim të një punësimi, të gjejë një vend pune në Shtetet e tjera anëtare.

Gjykata theksoi që autoritet kombëtare janë të detyruara t’u japin shtetasve komunitarë një periudhë kohe të mjaftueshme në mënyrë që t’i lejojë kërkimin e një vendi pune të përshtatshëm për kualifikimet e parashikuara në dispozita. Pasi kundërshtoi legjislacionin britanik që jepte një periudhë prej 6 muajsh, duke e konsideruar këtë periudhë të pamjaftueshme, Gjykata, theksoi se autoritet kombëtare nuk mund të detyrojnë një person që kërkon një vend pune të largohet nga vendi pritës, në përfundim të kohës, nëse ky ka mundësi konkrete për t’u punësuar. Nga ky vendim kuptohet se liria dhe lëvizja e lirë e nenit 45 nuk i përket

⁶ Çështja C-209/03 *Bidar v. London Borough of Ealing* [2005] I-2119.

⁷ Çështja C-209/03 *Bidar*, nr. 51 më lart, paragrafët 31-42.

⁸ Lidhja midis formimit profesional dhe kualitetit të punëtorit në legjislacionin komunitar, shfaqet në vendimin e çështjes *Lair*, të 21 qeshorit 1988, çështja 39/86. Gjykata theksoi se kualifikimi i punëtorit në baze të nenit 48 duhet të mbahet nga një person i cili ka lënë punën e tij dhe është regjistruar në një kurs të formimit profesional, dhe është e nevojshme një lidhje midis studimeve të ndërmarra dhe punës të mëparshme, kjo mund të mungojë kur personi gjendet i papunë jo vullnetarisht, në këtë rast frekuentimi i studimeve jo të lidhura me punësimin e mëparshëm nuk lejon humbjen e kualifikimit. Me të njëjtën frymë vendimi *Bernini*, me 26 shkurt 1992, çështja C-3/90, Racc. p. I-1071

vetëm atyre që kanë një punësim por dhe atyre personave që janë në kërkim të një pune në një shtet tjetër anëtar të Bashkimit Europian.

Gjykata Europiane e Drejtësisë ka dhënë kontributin e saj për të bërë me të qartë dhe të sigurt përmbajtjen e direktivës 2004/38/KE-së mbi lëvizjen e lirë të personave.

Gjykata në radhë të parë ka treguar se cilët janë parimet e përgjithshme të legjislacionit komunitar të cilat duhet të respektohen me patjetër nga ana e Shteteve anëtare, dhe ka theksuar pamundësinë e Shteteve për të kufizuar liritë themelore të Traktatit, sepse përjashtimet nga normat e Traktatit mund të interpretohen në mënyrë të ngushtë dhe të marra nën dritën e parimit të proporcionalitetit. Nga kjo del një sovranitet shtetëror i kufizuar, që nuk mund të konsiderohet absolut, e cila mund të shmangë kontrollin e institucioneve komunitare. Shumë rendësi merr rasti i masave që kufizojnë lirinë e lëvizjes në brendësi të Shtetit anëtar, të cilat mund të merren ndaj një shtetasi të huaj vetëm nëse mund t'i aplikohen dhe shtetasve kombëtar; ky parim parashikohet nga neni 22 i direktivës dhe që e ka rikthësuar disa herë Gjykata.

Në veçanti Gjykata, në vendimin e 7 qeshorit 2007, *Komisioni kundër Vendeve të Ulta*, që kishte si objekt një masë të një shkeljeje deklaroi Holandën si mos përmbushëse të detyrimeve komunitare sepse normativa në fuqi e këtij Shteti bënte të mundur “një lidhje sistematike dhe të drejtpërdrejte midis një dënimi penal dhe një mase dëbimi”⁹ (Vendimi 7 korrik 2007, *Commisioni vs. Holanda*, çështja C-50/06, GJED). Gjykata vendosi se disa kufizime “aplikohen njëllor edhe për qytetarët e Bashkimit që nuk jetojnë rregullisht në territorin e Shtetit anëtar pritës” dhe se “këto mund të dëbohen për arsye të rendit ose sigurisë publike brenda kufizimeve të vendosura”.

Një situatë e ngjashme ju paraqit Gjykatës me vendimin Jipa¹⁰ (Vendimi 10 korrik 2008, *Jipa*, çështja C-33/07, GJED) të 10 korrikut 2008. Në këtë rast Gjykata u thirr të interpretojë nenet 21 TKE –së dhe 27 të direktivës 2004/38 për të vlerësuar nëse ato ndalojnë një normativë kombëtare që lejon kufizimin e të drejtës së një shtetasi të një Shteti anëtar të shkojë në territorin e një Shteti tjetër

⁹ Vendimi i 7 qeshor 2007, *Komisioni k. Holandës*, çështja C-50/06, në këtë rast Gjykata dënoi Mbretërinë e Holandës për mos aplikimin shtetasve të Bashkimit europian direktiven 64/221/KE-se, sot e zëvendësuar nga direktiva 2004/28/KE-së, për koordinimin e masave speciale për transferimin dhe qëndrimin e të huajve, të justifikuar nga arsye të rendit publik, sigurisë publike dhe të shëndetit publik, dhe të një normative të përgjithshme mbi të huajt që mundeson “një lidhje sistematike dhe të drejtpërdrejtë midis një dënimi penal dhe një mase dëbimi”.

¹⁰ Vendimi i 10 korrik 2008, *Jipa*, çështja C-33/07. Çështja trajtonte situatën e një shtetas rumun që në 2006 ishte debuar nga Belgjika, legjislacioni i të cilës parashikon një kufizim të të drejtës të rihyerjes. Sipas Gjykatës një normative e këtij rangi nuk është e përjashtuar si e tillë nga legjislacioni komunitar “me kusht që nga një anë sjellja personale e këtij shtetasi përbën një rrezik të vërtetë e aktual e mjaftshëm serioz për të ndikuar në interesin themeltar të shoqërisë, dhe nga ana tjetër masa shtrënguese që do të merrte është aftë të garantojë realizimin e objektivit që ndjek e mos të tejkalojë cka është e nevojshme për arritjen e objektivit. I takon gjykatësit të vërtetojë nëse në çështjen përpara tij ekzistojnë këtë elemente”.

anëtar, në veçanti nëse më parë kishte qenë i dëbuar nga ky Shtet sepse ndodhej në një situatë jo ligjore. Sipas Gjykatës nuk mjafton për të justifikuar dëbimin, “trazimi i rendit shoqëror i pandarë nga çdo shkelje e ligjit”, por nevojitet që sjellja e të huajt të perbeje “një rrezik të vërtetë dhe mjaftueshmerisht serioz ndaj një interesi themelor të shoqërisë”.

Në një mori vendimesh Gjykata e Drejtësisë ka rikthësuar që neni 21 i Traktatit KE-së, së bashku me direktivën e përmendur i jep çdo shtetasi të Bashkimit të drejtën e qëndrimit në territorin e një Shteti anëtar, dhe ka nënvizuar nevojën për një interpretim të të drejtës të lëvizjes së lirë duke e parë me të drejtat themeltare, në veçanti me të drejtën e mbrojtjes së jetës familjare, të parimit të proporcionalitetit dhe ndalimit të diskriminimit.

Në vendimin *Metock*¹¹ (Vendimi 25 korrik 2008, *Metock*, çështja C-127-08, GJED) në 25 korrik 2008, Gjykata shikon në dispozitat e Qeverisë irlandeze një mos respektim të direktivës 2004/38/KE-së, e cila duke vendosur mënyrat e hyrjes, lëvizjes dhe qëndrimit për të afërmit e shtetasit të Bashkimit, i garanton qytetarëve të Bashkimit Europian të drejtën për të qëndruar në një Shtet anëtar. Në këto rrethana, vendosja e një kufizimi, familjarëve jo-komunitarëve të shtetasve, për të qëndruar në mënyrë të rregullt në një nga shtetet anëtare, siç deklarohet nga Qeveria irlandeze, përbente për Gjykatën një shkelje të direktivës.

Për këtë arsye Gjykata vendosi që “e drejta e një shtetasi jo-komunitar, bashkëshort i një shtetasi të BE-së, të shoqërojë apo të shkojë tek ai shtetas nuk mund të jetë i kushtëzuar nga një rezidence ligjore e mëparshme në një Shtet anëtar” dhe ka nënvizuar “që bashkëshorti jo – komunitar mund të përfitojë kushte të qëndrimit e të lëvizjes pavarësisht nga kur apo ku është lidhur martesë ose se si ka hyrë në Shtetin pritës”. Kështu “shtetasit e shteteve të treta”, familjarë të një shtetasi të Bashkimit, marrin nga direktiva 2004/38 të drejtën për të shkuar tek ky shtetas i Bashkimit në Shtetin anëtar pritës, pavarësisht nëse ky është vendosur aty para apo pas krijimit të familjes”.

Gjykata parashikon që asgjë nuk ndalon Shtetin të aplikojë ndaj një shtetasi të parregullt një dënim – si një gjobë proporcionale – pa ndërmarrë dëbimin.

Në të njëjtin vendim Gjykata vendosi dhe që direktiva 2004/38 të jetë e aplikuar ndaj çdo shtetasi të një shteti të tretë, familjari të një shteti të Bashkimit, i cili shoqëron apo arrin shtetasin e Bashkimit në një nga Shtet anëtare të ndryshëm nga ai që ka shtetësinë, dhe i jep të drejtën e hyrjes e të qëndrimit në këtë Shtet anëtar, pa bërë dallime nëse ky shtetas i një shteti të tretë ka qëndruar rregullisht në një Shtet tjetër anëtar.

¹¹ Vendimi i 25 korrik 2008, *Metock*, çështja C-127/08, Katër qytetar afrikanë kanë paraqitur apel pranë Gjykatës të Drejtësisë mbasi i është mohuar e drejta e qëndrimit edhe pse ishin martuar me shtetas europianë që qëndronin në Irlandë. Për Qeverinë irlandeze martesë me një qytetar të BE-së të një shtetasi jo të rregullt në territorin e 27 Shteteve anëtare, nuk i lejon rregullimin e qëndrimit të tij. Ai duhet të ketë të paktën një rezidence të rregullt në një Shtet anëtar.

Në çështjen *Foster*¹² (Vendimi 18 nëntor 2008, *Förster*, çështja C-158/07, GJED) më 18 nëntor 2008, Gjykata e Drejtësisë vendosi deri në ç'pikë mund të kushtëzohet e drejta e ndihmës për studime e parashikuar nga një normativë kombëtare, për studentët shtetas të një Shteti anëtar tjetër, që trajtimi i diferencuar të mos konsiderohet diskriminues.

Gjykata kujton që është e ligjshme për një Shtet anëtar të japi një ndihmë e një shumë të shpenzimeve për jetesë vetëm atyre studentëve të cilët kanë dhënë prova për një shkallë të caktuar të integritimit në shoqërinë e një Shteti. Ekzistenca e një shkalle integritimi mund të konsiderohet e provuar nëpërmjet vërtetimit se studenti ka jetuar për një periudhë të caktuar në Shtetin pritës.

Qëndrimi i pandërprerë për pesë vjet është në gjendje që të tregojë që ai i cili kërkon ndihmën është i integruar në Shtetin anëtar pritës. Kjo nuk mund të konsiderohet e tepërt.

Duke parathënë që normativa i mundëson të interesuarve njohjen e sigurt të të drejtave e detyrimeve të tyre, dhe që kushti i rezidencës për faktin e vetëm që ekziston është i tillë që të garantojë një nivel të sigurisë së ligjit dhe transparencë në fushën e dhënies së financimeve të studimeve të studentëve, Gjykata pohon që “e drejta komunitare nuk përjashton aplikimin ndaj shtetasve të Shteteve anëtare, me një situatë të mëparshme qëndrimi prej pesë vitesh”. Ajo që ka rëndësi sipas Gjykatës është fakti që studenti, i cili qëndron ligjërisht në një Shtet anëtar, mund të përfitojë nga ndalimi i çdo diskriminimi nga kombësia për marrjen e një burse studimi.

Në lidhje me martesën, kohët e fundit shtrohet dhe problemi i martesave të personave të të njëjtit seks. Këto martesa njihen më së shumti në disa shtete të BE-së, si në Holandë, Spanjë, Portugali dhe Belgjikë¹³. Ç'ndodh me këto çifte të cilat duan të transferohen për arsye punësimi në një Shtet tjetër Anëtar i BE-së? Rastet me të cilat mund të përballen çifte të tilla, në linja të përgjithshme, janë dy. Nëse bashkëshortët transferohen në një shtet i cili i njeh martesat ndërmjet

¹² Vendimi i 18 nëntor 2008, *Foster*, çështja C.158/07, mbi mosmarrëveshjen midis zonjës Forter, shtetase gjermane dhe Hoofddirectie Informatie Beheer Groep, mbi anulimin e pjesës së një burse studimi që ajo kishte përfituar nga një ligj i 2000 mbi financimin e studimeve në Holandë.

¹³ CALVO CARAVACA A.- CARRASCOSA GONZÁLES J., *I matrimoni tra persone dello stesso sesso*, në *La famiglia senzafrontiere*. Atti del Convegno tenuto presso la Facoltà di Giurisprudenza dell'Università degli studi di Milano il 25.05.2007, a cura di S.Bariatti – A.Galizia Danovi, fq. 81; N.Boschiero, *Lesunions homosexuelles à l'épreuve du droit international privé italien*, në *Rivista di diritto internazionale*, n. 1/2007, fq. 50; M.CARRILLO, *La legge spagnola sul matrimonio tra omosessuali ed i principi costituzionali*, në *Foro Italiano*, 2005, fq. 264; DE SCHUTTER O., *Homophobia and Discrimination on Grounds of Sexual Orientation*, (a cura di) European Union Agency for Fundamental Rights, 2008, fq. 67; R.ROMBOLI, *La legge spagnola sul matrimonio tra persone dello stesso sesso e la tutela delle coppie omosessuali in Italia. Note introduttive*, në *Foro Italiano*, 2005, fq. 256; N.PIGNATELLI, *Nozione di matrimonio e disciplina delle coppie omosessuali in Europa*, në *Foro Italiano*, 2005, fq. 260; E.E.GÓMEZ, *La legge spagnola sul matrimonio tra omosessuali e la Costituzione spagnola*, në *Foro Italiano*, 2005, fq. 267; E.LAUROBA, *La legge spagnola sul matrimonio tra omosessuali ed i principi del diritto civile spagnolo*, në *Foro Italiano*, 2005, fq. 272.

homoseksualëve (p.sh. një çift spanjoll që transferohet në Belgjikë) rregullimi ligjor i tyre do të jetë i njëjtë dhe do të vazhdojnë të konsiderohen të tillë edhe nga legjislati komunitar, në kuadër të bashkimit familjar. Nëse bashkëshortët transferohen në një vend i cili nuk parashikon në legjislatin e tij martesat e tilla, atëherë bashkëshortët nuk mund të quhen me “bashkëshortë” dhe situatën e tyre mund ta rregullojnë, nëse është e mundur, vetëm nëpërmjet legjislatit që rregullon bashkëjetesën në të gjitha format e saj¹⁴.

4. Konkluzione

Në Bashkimin Europian, subjektet që përfitojnë nga lëvizja e lirë ndahen në dy kategori: shtetasit komunitarë dhe shtetasit jo komunitarë. Shtetasit e Bashkimit Europian janë të gjithë personat, që kanë shtetësinë e një shteti anëtar të Bashkimit Europian. Personat që kanë dy shtetësi janë qytetarë të Bashkimit, nëse posedojnë shtetësinë, e të paktën një shtet të Bashkimit Europian. Në këtë këndvështrim, të gjithë shtetasit evropianë përfitojnë potencialisht nga kjo e drejtë. Shtetasit komunitarë i nënshtrohen rregullave të Bashkimit Europian vetëm në momentin që ata e ushtrojnë efektivisht këtë të drejtë. Për shembull, nëse një rregullore në Bashkimin Europian lidhur me lëvizjen e lirë i jep qytetarit të një shteti disa të drejta, me shumë se ato që u jep shteti shtetasve të vet, këta shtetas nuk mund t'i ushtrojnë këto të drejta nëse nuk dalin asnjëherë nga vendi i vet, pra nëse efektivisht nuk e ushtrojnë këtë të drejtë.

Më konkretisht, personat të cilët përfitojnë nga kjo e drejtë janë: të punësuarit – personat e punësuar dhe të varur nga drejtimi i një punëdhënësi “punëtorë me kontratë pune”; të vetëpunësuarit – personat të cilët ushtrojnë një punë (sipërmarrje) të lirë dhe të drejtën e qëndrimit; ofruesit e shërbimeve që ofrojnë një aktivitet ekonomik jo të rastësishëm në një Shtet anëtar të ndryshëm nga ai ku është qëndrimi; pensionistët; personat e punësuar, por që janë me *handicap* për shkak aksidenti në punë, familjarët e individëve të sapo përmendur dhe në mënyrë potenciale, të gjithë shtetasit që janë shtetas të një shteti anëtar, në Bashkimin Europian. Nga ana tjetër, shtetasit jo komunitarë që përfitojnë nga lëvizja e lirë janë të gjithë shtetasit, shtetas të një shteti, i cili nuk është anëtar i BE-së, që përfitojnë nga regjimi i lëvizjes së lirë nëpërmjet rregullave Shengen. Gjykata i ka zgjeruar këto kategori me interpretimet e saj nder vite, sidomos që nga viti 2008. Gjykata Evropiane e Drejtësisë ka dhënë kontributin e saj për të bërë me të qartë dhe të sigurt përmbajtjen e direktivës 2004/38/KE-së mbi lëvizjen e lirë të personave.

¹⁴ Këto martesa hyjnë në kategorinë e martesave që “nuk e kalojnë dot kufirin”, pra nuk janë të vlefshme në një shtet tjetër por vetëm në atë shtet në të cilin janë celebruar, ose në atë shtet ku e parashikojnë në të njëjtën mënyrë. CALVO CARAVACA A.- CARRASCOSA GONZÁLES J., *I matrimoni tra persone dello stesso sesso*, vep. e cit., fq. 85.

Gjykata në radhë të parë ka treguar se cilët janë parimet e përgjithshme të legjislacionit komunitar të cilat duhet të respektohen me patjetër nga ana e Shteteve anëtare, dhe ka theksuar pamundësinë e Shteteve për të kufizuar liritë themelore të Traktatit, sepse përjashtimet nga normat e Traktatit mund të interpretohen në mënyre të ngushtë dhe të marra nën dritën e parimit të proporcionalitetit. Nga kjo del një sovranitet shtetëror i kufizuar, që nuk mund të konsiderohet absolut, e cila mund të shmangë kontrollin e institucioneve komunitare.

Shumë mendimi merr rasti i masave që kufizojnë lirinë e lëvizjes në brendësi të Shtetit anëtar, të cilat mund të merren ndaj një shtetasi të huaj vetëm nëse mund t'i aplikohen dhe shtetasve kombëtar; ky parim parashikohet nga neni 22 i direktivës dhe që e ka rikthësuar disa herë Gjykata.

Në veçanti Gjykata, në vendimin e 7 qeshorit 2007, Komisioni kundër Vendeve të Ulta, që kishte si objekt një masë të një shkeljeje deklaroi Holandën si mos përmbushëse të detyrimeve komunitare sepse normativa në fuqi e këtij Shteti bënte të mundur “një lidhje sistematike dhe të drejtpërdrejte midis një dënimi penal dhe një mase dëbimi”¹⁵

Bibliografia

- ADOBATI E., (1995) *La libera circolazione delle persone*, Elementi di diritto comunitario, U.Draetta, Milano.
- ADOBATI E.- CIMOLINO G.P.- POLO M.- SANDRINI A., (1999) *La libera circolazione delle persone che esercitano un'attività economica*, Elementi di diritto dell'Unione Europea, U.Draetta e N.Parisi, Milano, p. 35.
- ALEXANDER ALENIKOFF T., – CHETAİL V., (2003) *Migration and International Legal Norms*, The Hague.
- ALGOSTINO A., (4/2003) *La condizione degli stranieri in Italia fra diritto universali e difesa della forza*, Diritto Pubblico comparato europeo, p. 622.
- AMBROSINI M., (2005) *Accoglienza degli immigrati e terzo settore*, Decimo Rapporto sulle migrazioni 2004, Milano.
- APAPJ., (2006) *Justice and Home Affaire in the EU*, Liberty and security issues after enlargement, Bruxelles.
- AVETA R., (2007) *Famiglie migranti e rischi di degradazione del legame parentale nella disciplina comunitaria sul ricongiungimento*, Diritti dell'uomo, p. 21.
- BALLARINO T., (2004) *Manuale breve di diritto dell'Unione europea*, Padova.
- BARATTA R., (2004) *La Convenzione sui diritti dei migranti e la normativa italiana sull'immigrazione*, Studi emigrazione, n. 153.

¹⁵ Vendimi i 7 qeshor 2007, Komisioni k. Holandës çështja C-50/06, në këtë rast Gjykata dënoi Mbretërinë e Holandës për mos aplikimin shtetasve të Bashkimit evropian direktiven 64/221/KE-se, sot e zvendësuar nga direktiva 2004/28/KE-se, për koordinimin e masave speciale për transferimin dhe qëndrimin e të huajve, të justifikuar nga arsye të rendit publik, sigurisë publike dhe të shëndetit publik, dhe të një normative të përgjithshme mbi të huajt që mundeson “një lidhje sistematike dhe të drejtpërdrejte midis një dënimi penal dhe një mase dëbimi”.

- BARATTA R., (2003) *La Convenzione delle Nazioni Unite sulla protezione dei lavoratori migranti: quali ostacoli all'adesione dei paesi di ricezione dei flussi migratori?* Rivista di diritto internazionale.
- BORGMANN Y. – PREBIL., (2008) *The rule of reason in European Citizenship*, European Law Journal, fq. 328.
- BRINKMANN G., (2002) *Family reunification of third-country nationals: access of family members to social protection benefits*, European Journal of migration and law.
- BROUWER E., (3/2005) *Effective Remedies in EU Immigration and Asylum Law: Justice Accessible to All?*, European Journal of Migration and Law, fq. 223.
- CANAJ E., (2014) *Lëvizja e lirë e personave në Bashkimin Evropian*, UETPRESS.
- CHALMAS D.- HADJIEMMANUIL C.- MONTI G.- TOMKINS A., (2006) *European Union Law*, Cambridge.
- CHALMERS D.- SZYSZCZAK E., (1998) *European Union Law. Volume two: Towards a European Polity*, Great Britain.
- CHOLEWINSKI R., (1997) *Migrant workers in International Human Rights*, Oxford.
- CHOLEWINSKI R. - PERUCHOUD R.- MACDONALD E., (2007) *International migration law. Developing paradigms and key challenges*, The Hague.
- DI PASCALE A., (2002) *The new regulations on immigration and the status of foreigners in Italy*, European Journal of Migration and Law.
- D'ORIANO F., (2003) *Ingresso e soggiorno nell'Unione europea del coniuge non comunitario del lavoratore migrante*, Diritto pubblico comparato ed europeo.
- DOUGAN M., (2006) *The constitutional dimension to the case law on Union citizenship*, European Law Review.
- DURANTE F. - GENNARELLI M.F., (1998) *I diritti dell'uomo in Italia. L'applicazione della Dichiarazione universale nell'ordinamento italiano*, Milano.
- GIUBBONI S., (3/2007) *Free movement of Persons and European Solidarity*, European Law Journal, fq. 360.
- GIUZZI V., (2000) *Manuale di diritto e politica dell'Unione Europea*, 2° ed., Editoriale, Scientifica.
- GUILD E.- NIESSEN J., (1996) *The developing immigration and asylum policies of the European Union*, Kluwer Law International.
- GUILD E., (2004) *The legal elements of European Identity – EU citizenship and Migration Law*, Kluwer Law International.
- GUILD E., (4/2004) *The variable subject of the EU Constitution, Civil Liberties and human rights*, European Journal of Migration and Law.
- GUILD E.- HARLOW C., (2001), *Implementing Amsterdam. Immigration and Asylum Rights in EC law*, Oxford.
- GUILD E., (2005) *What is a Neighbour? Examining the EU Neighbourhood Policy from the Perspective of Movement of Persons*, Paper.
- GROENENDIJK K.- FERNHOUT R.- VAN DAM D.- VAN OERS R.- Strik T., (2007) *The family Reunification Directive in EU Member States*, Nijmegen.
- GROENENDIJK K.- GUILD E.- BARZILAY R., (2000) *The Legal Status of Third Country Nationals who are Long-Term Residents in a Member State of the European Union*, Nijmegen.
- GROENENDIJK K., (2/2006) *Family reunification as a right under Community law*, European Journal of Migration and Law.
- GROENENDIJK K., (2/2004) *Legal concepts of integration in EU migration law*, European Journal of Migration and Law.

- GROUSSOT X., "Principled citizenship" and the process of european constitutionalization-From a pie in the sky to a sky with diamonds, U.Bernitz-Nergelius J.-Cardner, *General Principles of EC Law in a Process of Development*, cit., fq. 315
- HAILBRONNER K., (2000) *Immigration and Asylum Law and Policy of the European Union*, LAia.
- HAILBRONNER K., (1998) *European immigration and asylum law under the Amsterdam Treaty*, Common Market Law Review, fq. 1047.
- HANLON J., (2000) *European Community Law*, 2° ed., London.
- HANNUM H., (1987) *The right to leave and return in international law practice*, Martinus Nijhoff Publishers.
- HARTLEY T., (1976), *Public policy and internal free movement: a critical comment on Rutili Decision*, European Law Review, fq. 242.
- NASCIMBENE B., (2004), *Diritto degli stranieri*, Padova.
- NASCIMBENE B. (2002) *La libera circolazione dei lavoratori*, Milano.
- NASCIMBENE B., (1998) *Da Schengen a Maastricht. Apertura delle frontiere, cooperazione giudiziaria e di polizia*, Milano.
- NASCIMBENE B., E.M. MAFROLLA, (2002), *Recenti sviluppi della politica comunitaria in materia di immigrazione e asilo in Diritto, immigrazione e cittadinanza*, fq. 13.
- NASCIMBENE B., *La convenzione, la condizione dello straniero e la giurisprudenza*, in
- NASCIMBENE B. (2002) *La Convenzione europea dei diritti dell'uomo. Profili ed effetti nell'ordinamento italiano*, Milano .
- NASCIMBENE B., (2/2008) *L'approccio globale nella gestione dell'immigrazione: la politica della UE alla luce dell'attuazione del Programma dell'Aja*, Il Diritto dell'Unione europea
- NASCIMBENE B., (1993) *Le norme sul diritto d'asilo. Il caso italiano*, Diritti dell'uomo
- NASCIMBENE B., (1997) *La condizione giuridica dello straniero- Diritto vigente e prospettive di riforma*, Cedam.
- NASCIMBENE B., (1997) *Il matrimonio del cittadino italiano all'estero e dello straniero in Italia alla luce della riforma del sistema di diritto internazionale privato*, Collisio Legum-Studi di diritto internazionale per Gerargo Broggin, Milano.
- VILLANI U., (1997) *La politica dell'Unione europea in materia di immigrazione*, Il fenomeno dell'immigrazione clandestina: aspetti penali e di prevenzione criminale. Atti del Convegno di Studi di Diritto Penale, Bari,
- VILLANI V., (1998) *La cittadinanza dell'Unione europea*, Studi in ricordo di A.F.Panzer, vol. II, Diritto internazionale, Bari
- VILLANI U., (2008) *Istituzioni di diritto dell'Unione europea*, Bari.
- ZANELLI A.- ROMEO G., (2002) *Profili di diritto dell'Unione europea. Storia, istituzioni, aspetti giuridici dell'integrazione europea*, Milano.
- ZANETTI L., *I cambiamenti nella legislazione sui ricongiungimenti in alcuni paesi europei*, Ricongiungere la famiglia altrove Torino.
- ZANFRINI L., (2007) *Cittadinanze. Appartenenza e diritti nella società dell'immigrazione*, Bari.
- ZANGHÌ C., (2005) *Istituzioni di diritto dell'Unione Europea* Torino.

Risitë e Rregullores nr. 1215/2012 "Mbi Juridiksionin, Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve në fushën civile dhe tregtare"

Dok. Andja Levanaku

Abstrakt

Rregullorja 1215/2012 "Mbi Juridiksionin, Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve në fushën civile dhe tregtare" ka hyrë në fuqi në 10 janar 2015 në Bashkimin Europian. Kjo rregullore konsiderohet si një nga aktet më të rëndësishme dhe më me ndikim në të drejtën ndërkombëtare private, për shkak të fushës së gjërë të veprimit, në përcaktimin e çështjeve të rëndësishme: juridiksionin, njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore në çështjet civile dhe tregtare. Çështjet e juridiksionit dhe ekzekutimit të vendimeve në Bashkimin Europian janë rregulluar nga Konventa e Brukselit e miratuar në vitin 1968, fillimisht nga njëmbëdhjetë shtetet e para të Komunitet Europian, e me pas u miratua dhe nga shtetet e tjera që u bënë pjesë e Bashkimit Europian. Kjo konsiderohet si faza e parë në të cilën shtetet anëtare rregullonin marrëdhëniet juridike në këtë fushë. Konventa e Brukselit përfaqëson aktin e parë juridik që rregulloi marrëdhëniet mbi çështjet e juridiksionit. Qëllimi primar ishte parashikimi i rregullave dhe parimeve të përgjithshme që përcaktonin juridiksionin dhe njohjen e vendimeve të gjykatave në shtetet anëtare. Më pas, Bashkimi Europian miratoi në vitin 1988 Konventën e Luganos, "Mbi Juridiksionin, Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve në fushën civile dhe tregtare", e cila kishte të njëjtin qëllim si Konventa e Brukselit, e u shfuqizua nga rregullorja e Brukselit nr.44/2001, "Mbi Juridiksionin, Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve në fushën civile dhe tregtare. Rregullorja 1bis e Brukselit solli një sërë ndryshimesh ligjore në përcaktimin e juridiksionit, çështjes së gjyqëvarësisë, duke e zgjeruar rrethin e subjekteve që mund të jenë paditës dhe të padiur përpara gjykatave europiane, si dhe ndryshimi më i rëndësishëm, heqja e procedurës së ekzekutimit të vendimeve gjyqësore, e njohur